



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË PËR KOMUNITETE DHE KTHIM PËR VITIN 2021

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

**Prishtinë, qershor 2022**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale dhe jo kapitale ishte mbivlerësuar për 851,739€;
- C1 MKK kishte realizuar pagesa në vlerë 104,000€ për punonjës të angazhuar me Marrëveshje të Brukselit, të cilët nuk kanë dëshmi të plotë për vijueshmëri në punë; dhe
- A1 MKK ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 31,797€ në kategori ekonomike jo adekuate.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## **Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë për Komunitete dhe Kthim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## **Baza për konkluzion**

A2 Vonesa në realizimin e marrëveshjes (ndërtimin e shtëpive) për ri integrimin e të zhvendosurve.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri për Komunitete dhe Kthim është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme;
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm;

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti; dhe
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2021 ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 4,101,464€ me një ulje prej 8% në krahasim me vitin 2020. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara ishin të shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, pagesën e zyrtarëve të komunitetit serb në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë, vonesën në realizimin e marrëveshjes për ri integrim, pagesën e subvencioneve dhe menaxhimin e proceseve të prokurimit. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat i gabimeve si dhe mos harmonizimit vjetor kemi mbivlerësim material të pasurive.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, një (1) i përsëritur dhe dy (2) pjesërisht të përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale

#### Gjetja

Sipas nenit 13 pikës 1 dhe 2 të rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore e përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Ne identifikuar si në vijim:

- Investimet e MKK-së për infrastrukturë nëpër komuna në vlerë 381,043€, të cilat ishin përfunduar dhe pranuar teknikisht nuk ishin transferuar te komunat përkatëse këto pasuri. Si rezultat regjistri i pasurisë së MKK ishte i mbivlerësuar për këtë vlerë;
- Shtëpi të banimit për të kthyerit në vlerë 310,267€ të ndërtuara nga MKK, e për të cilat ishte bërë pranimi teknik gjatë vitit 2020 dhe 2021, ekzistojnë ende në regjistrin e pasurive të Ministrisë si investim në vijim dhe nuk ishte bartur pronësia tek përfituesit, duke mbivlerësuar pasuritë;
- Pasuritë në vlerë 159,910€ të cilat nuk e plotësonin kriterin për tu konsideruar si pasuri kanë mbetur në regjistrin e pasurive, përkundër që kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak; dhe
- Për tetë (8) pasuri jo kapitale në vlerë 4,085€ sistemi e-pasuria nuk kishte kalkuluar zhvlerësimin dhe si pasojë kemi një mbivlerësim të pasurive për 519€.

Duhet theksuar se gjatë fazës së auditimit (maj 2022) MKK ka bërë kërkesë në Thesar për largim të pasurive nga regjistri i SIMFK, dhe në dakordim me Thesarin pritet që gjatë vitit 2022 të korrigohet regjistri i pasurive.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës në zbatimin e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare nga zyrtarët përgjegjës.

#### Ndikimi

Regjistrimi i këtyre pasurive si pasuri të MKK dhe mos bartja e tyre në komuna përkatëse dhe te përfituesit kanë ndikuar që vlera e pasurive të jetë e mbivlerësuar.



**Rekomandimi B1** Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë tek përfituesit dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrit të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë në mënyrë që pasuritë të prezantohen drejt në PFV.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja C1 - Kompensimi i punonjësve pa vijueshmëri të plotë në punë**

**Gjetja** Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojta Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve, përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Në kuadër të kësaj marrëveshje për integrim, në MKK përmes akt-emërimeve janë punësuar 20 pjesëtarë të ashtuquajturës "Mbrojtja civile" të cilët marrin paga të rregullta mujore. Shpenzimet për pagat e tyre për vitin 2021 ishin 104,000€. MKK kishte filluar të punësuarit t'i angazhoj në monitorim të projekteve kapitale për disa ditë<sup>4</sup> gjatë vitit.

Kjo dukuri vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në krijimin e hapësirave fizike për punë, sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e plotë të kësaj kategorie të të punësuarve.

**Ndikimi** Pagesa e pagave për punonjës që nuk paraqiten në punë, shkakton dëmtim të buxhetit të ministrisë si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara me marrëveshje, pra integrimin e këtij komuniteti në sistemin e Republikës së Kosovës.

**Rekomandimi C1** Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve****Gjetja**

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MKK në vitin 2021 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 31,797€ në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar 30,623€ për furnizim me material ndërtimor për përfitues individual si dhe 1,174€ për blerjen e pesë (5) hidroforëve për ujë për përfitues individual. Këto shpenzime për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat që fondet ishin buxhetuar në kategorinë e investimeve kapitale.

**Ndikimi**

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

**Rekomandimi A1**

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Vonesa në realizimin e marrëveshjes për ri integrimin e të zhvendosurve

#### Gjetja

MKK dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në tetor të vitit 2018 kanë nënshkruar marrëveshje për "Mbështetjen financiare për aktivitetet e projektit Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë"<sup>5</sup>. Sipas kësaj marrëveshje MKK do të sigurojë mbështetje financiare 2,750,000€ ndërsa Bashkimi Evropian do të financoj me 8,000,000€.

Me këtë marrëveshje parashihet që zbatimin e plotë të projektit do ta realizoj IOM-i, kurse MKK do të njoftohet përmes raportimit në lidhje me progresin e projektit që ndërlidhet me fondet e transferuara nga MKK. Me fondet e MKK do tu ofrohet mbështetje financiare (ndërtim i shtëpive) për 98 familje. Projekti ishte paraparë të përfundoj me 31 maj 2021 por ishte vazhduar deri në fund të vitit 2022. MKK deri në maj të vitit 2022 ka transferuar shumën prej 2,500,000€. Sipas nenit 5.2 të marrëveshjes IOM do t'i dërgojë MKK raporte mujore, raporte vjetore narrative/financiare dy muaj pas çdo viti, dhe raportin final gjashtë muaj pas përfundimit të projektit.

Deri në fund të vitit 2021 janë përfunduar 35 shtëpi me mjetet financiare në vlerë prej 1,000,000€ të transferuara nga MKK në vitin 2018. Vonesat në përmbushjen e objektivës të paraparë me marrëveshje vërehen nga fakti që përkundër që MKK kishte transferuar 500,000€ në dhjetor 2020 dhe 500,000€ në shtator 2021, deri në fund të vitit 2021 nuk kishte ndërtime të reja. Nga vizitat në terren nga ekipi i auditimit në qershor 2022 vërehet se procesi për ndërtimin e 22 shtëpive tjera ishte në fazën fillestare (ndërtimi kishte filluar në maj të vitit 2022).

Edhe pse raportimi nga IOM-i ishte i rregullt dhe nga raportet mujore vërehej ngecje në realizim, menaxhmenti i MKK-së nuk ka kërkuar llogaridhënie për vonesat në realizimin e ndërtimeve të reja me fondet e paguara nga ana e tyre.

#### Ndikimi

Vonesat në përmbushjen e objektivës për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit ndikon në nivelin e riintegrit. Po ashtu, vonesat ndikojnë që përmbushja e objektivës të rrezikohet si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, duke mos arritur vlerën për parane e shpenzuar.

#### Rekomandimi A2

Ministri përmes personave përgjegjës duhet të mbikëqyrë në mënyrë më rigoroze realizimin e marrëveshjes. Po ashtu duhet të sigurojë se me fondet e ministrisë përmbushet plotësisht objektiva për ndërtimin e shtëpive sipas afateve të përcaktuara.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 284,287€, prej tyre ishin shpenzuar 235,018€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizim me kompjuterë, pajisje tjera, shërbime kontraktuese, furnizim me goma etj.

#### **Çështja A3 - Mos shfrytëzimi i të drejtës për të kërkuar informata sqaruese**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 39 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik pika 3, "Lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë".

Tek procedura e prokurimit "Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e MKK-së 2" në vlerë 9,129€, në njoftimin për kontratë, te kërkesat kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që të sigurohet nga OE broshurat për pajisjet e ofruara.

OE fitues kishte ofruar dëshmi vetëm për tri (3) pozicione nga 37 pozicione sa ishin gjithsej të kërkuara. Komisioni i vlerësimit nuk e kishte shfrytëzuar të drejtën për të kërkuar informata sqaruese sa i përket kësaj kërkesë, përmes E-Prokurimit siç kërkohet sipas rregullës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës nga ana e komisionit të ofertave të cilët nuk kishin treguar shkallë të lartë të përgjegjësisë në punën e tyre.

##### **Ndikimi**

Mos shfrytëzimi i mundësisë ligjore për sqarime shtesë rritë rrezikun në mos përbushjen e kontratës sipas specifikave të kërkuara.

##### **Rekomandimi A3**

Ministri, duhet të sigurojë që komisioni i vlerësimit bënë ekzaminimin e plotë të ofertave, dhe aty ku paraqitet nevoja për sqarime shtesë nga OE, të kërkojë informata sqaruese.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 74,843€, prej tyre ishin shpenzuar 73,329€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e personave fizik dhe juridik për zhvillim dhe stabilizim të komuniteteve.

### **Çështja A4 - Transferi i mjeteve financiare për përfituesit jo në përputhje me Udhëzuesin për subvencionim**

#### **Gjetja**

Plotësimi dhe ndryshimi i Udhëzuesit nr. 2431 për Subvencionimin e Projekteve dhe Aktiviteteve që Promovojnë të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëmarrjen e tyre në Republikën e Kosovës përkatësisht neni 13 pika 4 përcakton se MKK do të bëjë pagesën e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në dy pjesë, në pjesën e parë do të kryhet pagesa prej 80% të vlerës së aprovuar të projektit, ndërsa pjesa e dytë e pagesës prej 20% të vlerës së aprovuar të projektit, do të bëhet kur përfituesi i dorëzon në MKK raportet, faturat dhe dëshmitë tjera për realizimin e projektit.

Ne kemi identifikuar dy raste, kur projektet me vlerë financiare prej 8,970€, Ministria i kishte financuar duke bërë transferin e plotë të mjeteve (100%) tek përfituesit e subvencioneve, pa e ndarë pagesën në dy pjesë. Në fund të projektit këto mjete janë arsyetuar me dëshmi relevante nga përfituesit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e gabimeve teknike nga ana e zyrtarëve të MKK-së, duke mos zbatuar me përpikëri kërkesat e përcaktuara në Udhëzim.

#### **Ndikimi**

Transferi i plotë i mjeteve financiare, përveç që është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me udhëzuesin, rrit edhe rrezikun e mos realizimit të projektit në tërësi duke mos i arritur qëllimet e synuara me fondet publike.

#### **Rekomandimi A4**

Ministri, duhet të siguroj që pagesat për përfituesit të bëhen në përputhje me kriteret, në mënyrë që të arrijë të bëjë monitorimin e shpenzimeve dhe realizimin e projekteve, me qëllim që me këto subvencione të përmbushen objektivat e synuara të ministrisë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 21,497,563€, pasurive jokapitale është 61,553€, si dhe e stoqeve 29,147€.

#### **Çështja C2 - Mos harmonizimi në mes raporteve të inventarizimit dhe regjistrave të pasurisë**

##### **Gjetja**

Sipas nenit 18.1 të Rregullores – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Gjithashtu sipas nenit 24 të po të njëjtës rregullore "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

MKK edhe pse ka kryer inventarizimin, raporti i inventarizimit nuk është harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, për të verifikuar saktësinë e informatave rreth pasurive.

Harmonizimi nuk është kryer për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë.

##### **Ndikimi**

Harmonizimi i regjistrit të pasurive me inventarizim do të ndikonte direkt në identifikimin e pasurive të cilat nuk janë në pronësi të MKK duke mundësuar azhurnimin e regjistrit me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

##### **Rekomandimi C2**

Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive, në mënyrë që prezantimi i pasurive në PFV të jetë i saktë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>5,474,893</b>	<b>5,078,776</b>	<b>4,101,464</b>	<b>4,090,935</b>	<b>7,304,291</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	5,474,893	5,078,776	4,101,464	4,090,935	6,349,654
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	954,637
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	0

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 396,117€. Kjo ulje është rezultat i zvogëlimit të buxhetit me vendime të qeverisë.

Në vitin 2021 MKK ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 4,101,464€, me një ulje 8% në krahasim me vitin 2020.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>5,474,893</b>	<b>5,078,776</b>	<b>4,101,464</b>	<b>4,090,935</b>	<b>7,304,291</b>
Pagat dhe mëditjet	842,635	726,367	726,367	739,819	870,563
Mallrat dhe shërbimet	315,258	273,147	230,858	203,197	362,800
Komunalitë	17,000	11,140	4,160	4,759	10,838
Subvencionet dhe transferet	300,000	74,843	73,329	288,399	288,325
Investimet Kapitale	4,000,000	3,993,278	3,066,749	2,854,760	5,771,764

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 116,268€ me vendim të qeverisë si kursim buxhetor. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 42,111€ me vendim të qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 85%;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,860€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte zvogëlim për 5,000€, dhe me vendim të qeverisë kishte zvogëlim për 860€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 37%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 225,157€ me vendime të qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 98%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,722€ me vendim të qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori afër 77%. Realizimi i ulët i buxhetit për këtë kategori është për shkak të pamundësisë së pagesave në vlerë 801,581€ pasi që Operatorëve ekonomik ju ishin bllokuar llogaritë bankare nga Qeveria.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021





Sipas planifikimit buxheti fillestar i të hyrave jo tatimore ishte 3,635€ ndërsa pas rishikimit ishte 650€. Të hyrat e realizuara kanë të bëjnë me kthimin e mjeteve nga një organizatë në lidhje me tepricën e mjeteve pas përfundimit të projektit.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>3,635</b>	<b>650</b>	<b>2,778</b>	<b>1,819</b>	
Të hyrat jo tatimore	3,635	650			
Të hyrat tjera	0	0	2,778	1,819	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MKK ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. MKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tre (3) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë në proces, një (1) nuk është zbatuar dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar bartjen e pronësisë së pasurisë tek përfituesit dhe njëkohësisht të bëjë azhurnimin e regjistrin të pasurisë duke i larguar investimet në vijim të cilat tashmë i takojnë përfituesve tjerë. Më tutje, Ministri të sigurohet se pagesat të cilat nuk i takojnë kategorisë së investimeve kapitale të mos përfshihen në regjistrin e pasurisë dhe në RVF.	Edhe këtë vit kemi hasur në mbivlerësim të pasurive. Shih B1	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurohet që vlera e pasurisë të raportohet sipas vlerës neto, siç kërkohet me rregullën financiare në mënyrë që të siguroj raportim cilësor, të drejtë dhe të vërtetë në RVF.	Pasuritë nën 1,000 janë raportuar sipas vlerës neto nga sistemi e-pasuria.	I zbatuar
3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministri duhet të ndërmarrë masa konkrete që të eliminoj mangësitë e evidentuara lidhur me raportimin e buxhetit të hyrave jo tatimore në mënyrë që në të ardhmen PFV-të të pasqyrojnë pamje të plotë dhe të saktë.	Në PFV 2021 është prezantuar planifikimi i të hyrave.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj kontrole adekuate në fushën e personelit, të zgjidhë problemin e angazhimit të punonjësve në punë dhe të ndërmerren hapat e duhur për zbatimin e legjislacionit në fuqi duke siguruar menaxhim efikas dhe efektiv të organizatës në drejtim të realizimit të objektivave të saj.	MKK gjatë vitit 2021 kishte filluar t'i angazhoj disa nga këta zyrtar në monitorim të projekteve megjithatë këta zyrtar ende nuk paraqiten në punë. Shih C1.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që në mënyrë periodike, para përfundimit të vitit fiskal dhe para përgatitjes së PVF-ve të caktohet komisioni për inventarizim dhe sipas nevojës komisioni për vlerësim të pasurisë, në mënyrë që regjistrat e pasurive dhe raportimi i tyre të jetë i plotë dhe i saktë.	MKK ka themeluar komisionin për inventarizim të pasurive dhe komisioni ka kryer inventarizimin por raporti i inventarizimit nuk është harmonizuar me regjistrin e pasurisë. Shih C2	Pjesërisht i zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që regjistrat e pasurisë plotësohen dhe azhurnohen sipas kërkesave të rregulloreve në fuqi në mënyrë që këta regjistra të jenë të plotë dhe të saktë.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
7.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj zbatimin e të gjitha procedurave të kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe të bëhet protokollimi i faturave sipas legjislacionit në fuqi.	Gjatë trajtimit të detyrimeve kemi verifikuar se të gjitha faturat nënshkruhen nga zyrtari I pranimit dhe ishin të evidentuar në librin e faturave të pranuar.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit




Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
РЕПУБЛИКА КОСОВО-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - ВЛАДА-GOVERNMENT  
MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM/ МИНИСТАРСТВО ЗА ЗАЈЕДНИЦЕ И  
ПОВРАТАК / MINISTRY FOR COMMUNITIES AND RETURN

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrit të Komunitetit dhe Kthimit**, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Goran Rakic

Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Data: 23.06.2022



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Angazhimi i tyre ishte nga një (1) deri në 25 ditë pune gjatë vitit
- <sup>5</sup> Marrëveshja rrjedh nga Instrumenti për Asistencë për para-anëtarësim (EU-IPA II) IPA 2016/039/744/03.
- <sup>6</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.